

Njoftim për përqendrim ndërmjet HTL Makedonija SHPKNJP Shkup dhe RoJal Igl SHPK Shkup,

(lënda nr. 08-53/2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 17.03.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga **HTL Makedonija SHPKNJP Shkup, Rr. 50-të Divizioni nr. 24 a Shkup, mbi Rojal Igl SHPK Shkup, rr. Prashka nr. 23 Shkup**, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

HTL Makedonija SHPKNJP Shkup kryesisht merret me lojërat e fatit. Është pjesë e grupit Novomatik. Grupi Novomatik është një grup shoqërisht të lojërave të fatit dhe lojërave argëtuese. Grupi Novomatik prodhon dhe shet teknologji dhe pajisje për lojërat e fatit dhe lojërat zbavitëse dhe menaxhon një sërë objektesh lojërash të fatit dhe zbavitëse, objekte bastesh (p.sh. kazino, baste sportive, automat klube), mundëson lojëra fati në internet (online) dhe celular dhe lojëra zbavitëse si dhe shërbime bastesh.

HTL Makedonija SHPKNJP Shkup është 100% në pronësi të Novomatic AG Austria. Novomatic AG ka një shoqëri të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe ajo është MAKOTEN SHPKNJP Gjevgjeli.

HTL Makedonija SHPKNJP Shkup ka dy kompani bijë në Republikën e Maqedonisë së Veriut: MA GAMING SHPKNJP Shkup dhe MASTERBET SHPKNJP Shkup.

Rojal Igl SHPK Shkup kryesisht merret me bixhoz dhe baste

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

20.03. 2023

Shkup